



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA GRAMSH
SEKTORI I STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT URBAN

Nr. 852 Prot

Gramsh, më 11.12.2017

NJOFTIM

**DËGJESA E DYTË PUBLIKE PËR HARTIMIN E RAPORTIT PERFUNDIMTAR
TË VLERESIMIT STRATEGJIK MJEDISOR TE PLANIT TË PËRGJITHSHËM
VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

Bashkia Gramsh ka ndërmarrë nismën për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.07.2014, "Për ndarje administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", dhenë zbatim të parashikimeve të Ligjit Nr.107/2014 " Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Ligjit Nr. 10 431, datë 09.06.2013, "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe Ligjit Nr.91, datë 28.02.2013 " Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor".

Për këtë qëllim, Bashkia Gramsh ka vendosur të organizojë dëgjesën e dytë publike në kuadër të raportit përfundimtar të Vlerësimit Strategjik Mjedisor *ditën e Enjte, date 21 dhjetor 2017, ora 13⁰⁰, tek Pallati i Kulturës "Thoma Prifti", Gramsh.*

Në dëgjesë ftojmë grupet e interes dhe qytetarët e bashkisë për çështjet që do të trajtohen në raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) në kuadër të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gramsh.

Në raportin Përfundimtar të VSM-së do të trajtohen çështjet, si: gjendjen mjedisore në mënyrë të përmbledhur të territorit të Bashkisë Gramsh, vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të propozuara të PPV-së, masat që propozohen për të zbutur ndikimin në mjedis dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit. Në fund të prezantimit është parashikur të prezantohet plani I veprimit në mënyrë, që të garantohet zbatimi I masave mbrojtëse mjedisore.

Me respekt,

Kryetari i Bashkisë Gramsh

Luljeta Dyllani

